



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOV
KOMUNA E ISTOGUT - OPŠTINA ISTOK
DIREKTORATI PËR ADMINISTRATËN - DIREKCIJA PËR Z. 21

00 Nr./Br. 033-117¹¹ Nr. i faq/Br.str. 16

Data/Datumi 31 / 12 / 2024
ISTOG • ISTOK



KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOK
MUNICIPALITY OF ISTOK

01 Numër: 179/2024
Data: 27.12.2024

[:http://kk.rks-gov.net/istog/](http://kk.rks-gov.net/istog/)

Rregullore Komunale Nr. /2024

KUVENDI I KOMUNËS

**PLOTËSIM NDRYSHIMI I RREGULLORES KOMUNALE Nr.2/2022
PËR KATEGORIZIMIN E KLUBEVE SPORTIVE**

Dhjetor /2024

Kuvendi i Komunës, bazuar ne Nenin 11, Nenin 12 paragrafi 12.2 pika (c) dhe Neni 40 paragrafi 40.2 pika (a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), Nenin 44 paragrafi 1 nenparagrafi 1.3. të Ligjit Nr. 08/L-277 për Sport (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.15/2024) dhe Nenin 33, paragrafi 33.1 paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Istogut 01 Numër 62/2010 i miratuar në Kuvendin e Komunës me datë 30.11.2010, ne mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2024, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR KATEGORIZIMIN E KLUBEVE SPORTIVE

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton rregullat, kriteret, procedurat dhe poentimin për kategorizimin e Klubeve Sportive të Komunës së Istogut që marrin pjesë në garat sportive të organizuara nga Federatat Sportive të regjistruara në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport të Republikës së Kosovës dhe në Komunën e Istogut.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Dispozitat e kësaj Rregulloreje rregullojnë:
 - 1.1. Mënyra e Kategorizimit të Klubeve Sportive;
 - 1.2. Kriteret për Kategorizimin e Klubeve Sportive;
 - 1.3. Procedurat për Kategorizimin e të gjitha Klubeve Sportive;
 - 1.4. Procedurat e ankimimit;
 - 1.5. Dispozitat përfundimtare.

Neni 3 Mënyra e Kategorizimit të Klubeve Sportive

1. Kategorizimin e Klubeve Sportive e bënë Komisioni për Kategorizimin e Klubeve Sportive të Komunës së Istogut, duke marrë parasysh kriteret për Kategorizimin e Klubeve Sportive të cilat janë përcaktuar në dispozitat e kësaj Rregullore.
2. Në bazë të kësaj Rregulloreje, Kategorizimi i Klubeve Sportive të Komunës së Istogut bëhet një herë në vit, dhe për të fituar të drejtën për Kategorizim, Klubet Sportive duhet të sjellin dokumentacionin si në vijim:

- 2.1. Certifikatën e regjistrimit të klubit;
 - 2.2. Certifikata e Nr. Fiskal;
 - 2.3. Konfirmimi i llogarisë bankare të klubit;
 - 2.4. Kopja e letërnjoftimit/pasaportës të përfaqësuesit të klubit;
 - 2.5. Vërtetim që klubi nuk ka obligime tataimore nga ATK;
 - 2.6. Plani i veprimit;
 - 2.7. Plani strategjik;
 - 2.8. Raporti i punës dhe raporti financiar nga një auditor i pavarur (për Klubet që plotësojnë kriteret për auditim sipas Ligjit për Sport), për vitin paraprak;
3. Të gjitha dëshmitë që kërkohen për përmbushjen e kriteve për poentim duhet të jenë të lëshuara nga Federatat përkatëse të sportit.

Neni 4

Kriteret për Kategorizimin e Klubeve Sportive

1. Kriteret për Kategorizimin e Klubeve të Sportit janë si në vijim:

- 1.1. Kategoria e sportit, sipas Kategorizimit Nacional të Sporteve - **KRITERI I**;
 - 1.2. Tradita e Klubit Sportiv (viti i themelimit të Klubit) – **KRITERI II**;
 - 1.3. Numri i sportistëve të regjistruar – **KRITERI III**;
 - 1.4. Niveli i garave ku merrë pjesë Klubi – **KRITERI IV**;
 - 1.5. Rezultatet e arritura sportive - **KRITERI V**;
 - 1.6. Angazhimi në Përfaqësuese të Kosovës – **KRITERI VI**;
 - 1.7. Pjesëmarrja e Klubeve në aktivitete dhe gara – **KRITERI VII**;
 - 1.8. Ngritja e kapaciteteve – **KRITERI IX**;
2. Përmbushja e kriteve nga Neni 4 i kësaj Rregulloreje përfshinë të gjitha kategoritë (të gjitha grup – moshat për meshkuj dhe femra) të sportistëve, por numri i pikëve për kategoritë e reja zvogëlohet, dhe vlen poentimi sipas tabelës dhe ndarjes së grupmoshave si në vijim:
- 2.1. Nxënësit e rinjë (7, 8, 9 vjeç) ose U7, U8, U9 dhe U10
 - 2.2. Nxënësit (10, 11 vjeç) ose grupmosha U12
 - 2.3. Kadetët e rinjë (12, 13 vjeç) ose grupmosha U14 (nën 14 vjeç)
 - 2.4. Kadetët (14, 15 vjeç) ose U16 (kategori ndërkombtare e garimit)

- 2.5. Juniorët (16, 17 vjeç) ose U18
 2.6. Seniorët e rinjë (18, 19, 20 vjeç) ose U21
 2.7. Seniorët (mosha mbi 18 vjeç)

| Grupmosha / kategoria | Koeficienti në raport me pikët e seniorëve (100 %) |
|---|--|
| Senioret (18 +) | 1/1 (100 %) |
| Seniorët e rinjë (18, 19, 20 vjeç) U21 | 3/4 (75 %) |
| Juniorët (16, 17 vjeç) U18 | 1/2/ (50 %) |
| Kadetët (14, 15 vjeç) U16 | 1/3 (33.33 %) |
| Sportist e rinjë (U7 - U10, nxënësit U12 dhe Kadetët e rinjë 12, 13 vjeç U14) | 1/4 (25 %) |
| | |

3. Rezultati sportiv që arrinë një Klub i sportit individual njihet si rezultat i sportit ekipor, me kusht që ky rezultat të jetë i pranuar nga Federata përkatëse e sportit.
4. Klubet sportive që kanë të regjistruar në federat sportistë femra dhe meshkuj, 30% femra dhe 70% meshkuj (3 pikë), 20% femra dhe 80% meshkuj (2 pikë), dhe 10% femra dhe 90% meshkuj (1 pikë).

Neni 5

Procedura për Kategorizimin e Klubeve Sportive

1. Komisionin për Kategorizimin e Klubeve Sportive e themelon me vendim Kryetari i Komunës duke respektuar Ligjin Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore me këtë përbërje:

Komisioni përbëhet nga 5 anëtar,

- 1.1.Kryesues i Komisionit Drejtori i DKRS-së
- 1.2.Një anëtar i dëshmuar në fushën e sportit
- 1.3.Tre anëtarë nga institucioni
- 1.4.Një anëtar rezervë

2. Komisioni gjatë punës mbanë procesverbalin, i cili në fund nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.
3. Komisioni vlerëson me pikë Klubet sipas kriterëve të përcaktuara në këtë Rregullore dhe vendimin për Kategorizimin e Klubeve Sportive duhet t'a marrë më së largu deri me 31 Mars.

Neni 6

Dërgimi i formularit për aplikim

1. DKRS-ja, më së largu deri me datën 1 Mars publikon në faqen e Komunës thirrjen publike për Kategorizim të Klubeve Sportive. Në formular përcaktohen dëshmitë përkatëse që duhet të sjellë Klubi.
2. Vlera totale financiare për Kategorizimit të Klubeve Sportive caktohet me njoftim nga DKRS.
3. Klubet Sportive janë të obliguara të plotësojnë formularin dhe t'ia bashkëngjesin dokumentacionin mbështetës sipas kërkesës në formular së bashku me dëshmitë përkatëse, të cilat i dërgojnë në DKRS-së përmes Qendrës për Shërbim të Qytetarëve Nr.100, në zarf të mbyllur, më së voni deri më 15 Mars.
4. Nëse klubet përkatëse dorëzojnë formularin dhe dokumentacionin përkatës me vonesë, ose konstatohet se dëshmitë e bashkëngjitura nuk kanë qenë ashtu si janë kërkuar në formular, i njejti aplikim nuk pranohet dhe Klubi nuk do të kategorizohet.

Neni 7

Shqyrtimi i dokumentacionit dhe lista ranguese

1. Komisioni, shqyrton aplikacionet duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore;
2. Komisioni bënë vlerësimin e dokumentacionit përkatës, i përgatit propozimet për rangim, të cilat pastaj i miraton.
3. Komisioni është i obliguar që listën me Kategorizim të Klubeve Sportive t'a miratoj më së largu deri më 31 Mars.

Neni 8

E drejta e ankesës, afatet dhe procedura

1. Klubet e pakënaqura me poentim dhe radhitjen në grupe, mund të parashtrojnë ankesën e tyre në Komisionin për Ankesa në afat prej 5 ditësh, pas publikimit së listës.

2. Komisioni i Ankesave për Kategorizimin e Klubeve Sportive të Komunës së Istogut, pas shqyrtimit të Ankesës vendos me shumicë votash dhe nxjerr vendim përfundimtar pas 5 ditësh lidhur me ankesën e parashtruar.
3. Komisionin për Ankesa lidhur me Kategorizimin e Klubeve Sportive të Komunës së Istogut e themelon Kryetari i Komunës.
4. Komisioni i Ankesave ka Kryetarin (që duhet të jetë jurist) dhe 2 anëtarë tjerë, të cilët në asnjë mënyrë nuk duhet të jenë anëtarë të emëruar politik. Komisioni do të ketë mandat 2 vjeçar.
5. Kundër vendimit të Komisionit për Ankesa nuk mund të parashtrohet ankesë në institucion.

Neni 9

Vendimi për Kategorizimin e Klubeve Sportive

Komisioni për Kategorizimin e Klubeve Sportive është i obliguar të pres vendimin e fundit të Komisionit për Ankesa lidhur me Kategorizimin e Klubeve Sportive dhe të vendosë në pajtim me vendimin përfundimtar të Komisionit për Ankesa për Kategorizimin e Klubeve Sportive dhe të publikohet lista.

Neni 10

Mbështetja financiare e Klubeve Sportive sipas Kategorizimit

1. Mbështetja financiare për Klubet Sportive bëhet duke pasur për bazë Kategorizimin e Klubit Sportiv për vitin e fundit si dhe buxhetin e aprovuar për vitin përkatës.
2. Pas vendimit të Komisionit për Kategorizimin e Klubeve Sportive, DKRS rekomandon marrëveshje me shkrim për mbështetje financiare me Klubet Sportive përkatëse duke u mbështetur në planin e aktiviteteve dhe atë financiar të paraqitura nga Klubet Sportive.

Neni 11

Shtojca e Rregullores

1. Komisioni për Kategorizimin e Klubeve Sportive të Komunës së Istogut, është i obliguar që të hartojë formularin me pyetje përkatëse, duke përfshirë të gjitha kriteret dhe kushtet e përcaktuara me këtë Rregullore.
2. Tabela poentuese dhe formulari me pyetjet përkatëse janë pjesë përbërëse e kësaj Rregullore.

Neni 12
Ndryshimet dhe plotësimet

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregullore bëhen në të njejtën mënyrë sikurse dhe miratimi i saj.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pasi të plotësohen kushtet e parapara konform neneve 81 dhe 82 të LVL-së, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në web faqen e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Z. Enver Rugova





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO



KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOK
OPŠTINA ISTOK

**TABELA POENTUESE PËR
KATEGORIZIMIN E KLUBEVE SPORTIVE**

| Nr. | KRITERET | Pikët |
|------------|--|--------------|
| 1. | Kategorizimi i Sportit në nivel Nacional | |
| 1.1 | Kategoria A | 4.0 |
| 1.2 | Kategoria B | 1.5(2.0) |
| 1.3 | Kategoria C | 1.0 |
| 1.4 | Kategoria D | 0.5 |
| 2. | Tradia e Klubit | |
| 2.1 | Klubi me traditë i formuar nga 1990 dhe më përpara | 2.0 |
| 2.2 | Klubi me traditë i formuar nga 1991-2000 | 1.5 |
| 2.3 | Klubi me traditë i formuar nga 2001-2015 | 1.0 |
| 2.4 | Klubi me traditë i formuar nga 2015 e tutje | 0.5 |
| 3. | Numri Sportistëve të regjistruar | |
| 3.1 | 60 sportistë e më shumë | 4.0 |
| 3.2 | Nga 40-59 sportistë | 3.0 |
| 3.3 | Nga 20-39 sportistë | 2.0 |
| 3.4 | Nga 10-19 sportistë | 1.0 |
| 4 | Niveli i garave | |
| 4.1 | Klubi që garon në ligën e I | 6.0 |
| 4.2 | Klubi që garon në ligën e II | 4.0 |
| 4.3 | Klubi që garon në ligën e III | 2.0 |
| 4.4 | Klubi që garon në Ligë Unike | 4.0 |
| 5. | Rezultatet e arritura sportive | |
| 5.1 | Rezultatet e arritura sportive në sportet ekipore | |
| 5.1.1 | Klubi – Super Liga (Liga I) – Vendi I | 20 |

| | | |
|--|--|-----|
| 5.1.2 | Klubi – Super Liga (Liga I) – Vendi II | 15 |
| 5.1.3 | Klubi – Liga I ose Liga e II – Vendi I | 12 |
| 5.1.4 | Klubi – Liga I ose Liga e II – Vendi II | 8.0 |
| 5.1.5 | Klubi – Liga II ose Liga III – Vendi I | 6.0 |
| 5.1.6 | Klubi – Liga II ose Liga III – Vendi II | 4.0 |
| 5.1.7 | Klubi i cili merr pjesë në gara ndërkombëtare. (për çdo raund të kaluar në këto gara klubi poentohet me +1 pikë) | 4.0 |
| 5.2 Rezultatet e arritura sportive në garat për Kupën e Kosovës | | |
| 5.2.1 | Klubi – Fitues i Kupës së Kosovës | 15 |
| 5.2.1 | Klubi – Finalist i Kupës së Kosovës | 11 |
| 5.2.3 | Klubi – Gjysëm finalist i Kupës së Kosovës (1/2 e finales së Kupës) | 4.0 |
| 5.3 Rezultatet e arritura sportive në sportet individuale | | |
| 5.3.1 | Për çdo medalje në Lojërat Olimpike klubi merr | |
| | - Për medaljen e artë | 100 |
| | - Për medaljen e argjendtë | 70 |
| | - Për medaljen e bronzte | 45 |
| | Kurse për vendet 4 – 8 merr respektivisht 30, 25, 22, 18 dhe 16 pikë | |
| 5.3.2 | Për çdo medalje në Kampionate Botërore klubi merr | |
| | - Për medaljen e artë | 85 |
| | - Për medaljen e argjendtë | 60 |
| | - Për medaljen e bronzte | 35 |
| | Kurse për vendet 4 – 8 merr respektivisht 28, 24, 22, 18 dhe 15 pikë | |
| 5.3.3 | Për çdo medalje në Kupa Botërore klubi merr | |
| | - Për medaljen e artë | 65 |
| | - Për medaljen e argjendtë | 45 |
| | - Për medaljen e bronzte | 30 |
| | Kurse për vendet 4 – 8 merr respektivisht 22, 18, 15, 12 dhe 10 pikë | |
| 5.3.4 | Për çdo medalje në Lojërat dhe Kampionatet Europiane klubi merr | |
| | - Për medaljen e artë | 55 |
| | - Për medaljen e argjendtë | 40 |
| | - Për medaljen e bronzte | 25 |
| | Kurse për vendet 4 – 8 merr respektivisht 20, 15, 12, 9 dhe 7 pikë | |
| 5.3.5 | Për çdo medalje në Kupat Europiane klubi merr | |
| | - Për medaljen e artë | 45 |
| | - Për medaljen e argjendtë | 30 |
| | - Për medaljen e bronzte | 20 |
| | Kurse për vendet 4 – 8 merr respektivisht 15, 12, 10, 8 dhe 6 pikë | |
| 5.3.6 | Për çdo medalje në Lojërat dhe Kampionatet Mesdhetare klubi merr | |

| | | |
|--------|---|-----|
| | - Për medaljen e artë | 20 |
| | - Për medaljen e argjendtë | 14 |
| | - Për medaljen e bronzte | 8 |
| | Kurse për vendet 4 – 6 merr respektivisht 5, 4 dhe 3 pikë | |
| 5.3.7 | Për çdo medalje në Kampionatet Ballkanike klubi merr | |
| | - Për medaljen e artë | 15 |
| | - Për medaljen e argjendtë | 10 |
| | - Për medaljen e bronzte | 6 |
| | Kurse për vendet 4 – 5 merr respektivisht 4 dhe 3 pikë | |
| 5.3.8 | Për çdo medalje në Kampionatin e Kosovës klubi merr | |
| | - Për medaljen e artë | 4 |
| | - Për medaljen e argjendtë | 3 |
| | - Për medaljen e bronzte | 2 |
| 5.3.9 | Për çdo medalje në Kupën e Kosovës klubi merr | |
| | - Për medaljen e artë | 3 |
| | - Për medaljen e argjendtë | 2 |
| | - Për medaljen e bronzte | 1 |
| 5.3.10 | | |
| | | |
| | | |
| | 6. Angazhimi në përfaqësuese | |
| 6.1 | Për çdo sportist të angazhuar në përfaqësuese | 2.0 |
| 6.2 | Për çdo trajner të angazhuar në përfaqësuese | 2.0 |
| | | |
| | 7. Pjesëmarrja në gara | |
| 7.1 | Klubi që merrë pjesë në 30 e më shumë gara | 4.0 |
| 7.2 | Klubi që merrë pjesë në 20-29 gara | 3.0 |
| 7.3 | Klubi që merrë pjesë në 15-19 gara | 2.0 |
| | 8. Ngritja e kapaciteteve | |
| 8.1 | Për çdo trajner me licencë të njohur ndërkombëtare | 3.0 |
| 8.2 | Për çdo trajner me licencë të njohur nacionale | 2.0 |
| 8.3 | Për çdo administrator të sportit me licencë të njohur | 1.0 |
| | | |
| | | |
| | | |



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO



KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOK
OPŠTINA ISTOK

FORMULARI PËR APLIKIM PËR KATEGORIZIMIN E KLUBEVE
SPORTIVE

Istog, më: ___ / ___ / _____.

Klubi: _____

Përfaqësuesi/ja i/e klubit: _____

Tel: _____

E-mail: _____

Kriteri 1: Sipas rangut të sportit në nivel nacional.

NË CILËN KATEGORI, RANG BËNË PJESË SPORTI ME TË CILIN MERRET KLUBI
JUAJ, SIPAS KATEGORIZIMIT NACIONAL?

Duhet të sillni deshmi për të vërtetuar të dhënat

➤ Në rangun I



| | |
|-----------------|--------------------------|
| ➤ Në rangun II | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Në rangun III | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Në rangun IV | <input type="checkbox"/> |

Kriteri 2: Tradita e klubit

| | |
|---|--------------------------|
| <p>CILA ËSHTË TRADITA E KLUBIT TUAJ, APO KUR ËSHTË FORMUAR KLUBI JUAJ? Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat.</p> | |
| ➤ Klubi me traditë i formuar nga viti 1990 dhe më përpara | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi me traditë i formuar nga viti 1991-2000 | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi me traditë i formuar nga viti 2001-2015 | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi me traditë i formuar nga viti -2015 e tutje | <input type="checkbox"/> |

Kriteri 3: Masiviteti sipas numrit të sportistëve të regjistruar në federatë

| | |
|--|--------------------------|
| <p>SA ËSHTË NUMRI I SPORTISTEVE TË KLUBIT TUAJ TË REGJISTRUAR NË FEDERATËN TUAJ PËRKATËSE? Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat, të bashkangjitet lista e sportistëve të regjistruar.</p> | |
| ➤ Klubi ka të regjistruar 60 sportistë e më shumë | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi ka të regjistruar 40-59 sportistë | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi ka të regjistruar 20-39 sportistë | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi ka të regjistruar 10-19 sportistë | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Nëse raporti i numrit të përgjithshëm të femrave sportiste me numrin e meshkujve sportistë është së paku 30:70 | <input type="checkbox"/> |

Kriteri 4: Niveli i garave, rangu ku klubi zhvillon gara

| | |
|--|--------------------------|
| <p>NË CILIN NIVEL, RANG APO KATEGORI ZHVILLON GARA KLUBI I JUAJ? Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja</p> | |
| ➤ Klubi juaj bënë gara në rangun e parë të garave në federatën tuaj | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi juaj bënë gara në rangun e dytë të garave në federatën tuaj | <input type="checkbox"/> |

➤ Klubi juaj bënë gara në rangun e tretë të garave në federatën tuaj



Kriteri 5: Rezultatet sportive

Kriteri 5.1: Rezultatet e arritura në garat ndërkombëtare

A KENI NDONJË SPORTISTË NË KLUBIN TUAJ QË KA FITUAR MEDALJE NË LOJRAT OLIMPIKE (LO), NË LOJRAT PARA – OLIMPIKE, NË KAMPIONATIN BOTËROR (KB) LOJRAT DHE KAMPIONATET EVROPIANE, LOJRAT MESDHETARE APO KAMPIONATET BALLKANIKE, APO QË ËSHTË RADHITUR NGA VENDI 4-TË DERI NË VENDIN E 8-TË.

Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja

| | |
|--|--|
| ➤ Shëno kampionatin, Garën në të cilën është arritur rezultati (vendi, data) | |
| ➤ Emri dhe Mbiemri i Sportistit | |
| ➤ Rezultati i arritur | |
| ➤ Kategoria/ disiplina | |

Kriteri 5.2: Rezultatet e arritura në garat vendore

A KENI NDONJË SPORTIST NË KLUBIN TUAJ QË KA FITUAR MEDALJE TË ARTË, TË ARGJENDTË APO TË BRONZTË NË KAMPIONATIN E KOSOVËS, APO NË NË KUPËN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS?

Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja

| | |
|---|--|
| ➤ Shëno Kampionatin, garën ku është arritur rezultati (vendi, data) | |
| ➤ Emri dhe Mbiemri i sportistit | |
| ➤ Rezultati i arritur | |

| | |
|------------------------|--|
| ➤ Kategoria/ disiplina | |
|------------------------|--|

Kriteri 6: Përfaqësimi, angazhimi i sportistëve dhe trajnerëve në përfaqësuese

| | |
|--|--------------------------|
| A KENI NDONJË SPORTIST APO TRAJNER NË KLUBIN TUAJ I CILI ËSHTË ANGAZHUAR NË PËRFAQËSUESEN E KOSOVËS? | |
| Duhet të sillni deshmi për të vertetuar të dhënat tuaja. | |
| ➤ Klubi juaj në përfaqësuesen e Kosovës a ka të angazhuar sportist | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi juaj në përfaqësuesen e Kosovës a ka të angazhuar trajner | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Emri dhe Mbiemri i sportistit apo trajnerit | |
| ➤ Kategoria | |

Kriteri 7: Pjesëmarrja në aktivitete dhe gara

| | |
|--|--------------------------|
| A KA MARRË PJESE KLUBI JUAJ NË AKTIVITETE APO GARA TË NDRYSHME SPORTIVE? SHËNONI NË SA PREJ TYRE DHE CILAT JANË ATO? | |
| Duhet të sillni deshmi për të vertetuar të dhënat tuaja. | |
| ➤ Klubi juaj ka marrë pjesë në 30 e më shumë aktivitete gjatë vitit | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi juaj ka marrë pjesë në 20-29 aktivitete gjatë vitit | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi juaj ka marrë pjesë në 15 - 19 aktivitete gjatë vitit | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Përshkrimi i aktivitetit të organizuar | |
| ➤ Data | |
| ➤ Vendi | |

Kriteri 9: Ngritja e kapaciteteve

A KENI NDONJË ZYRTARË TË SPORTIT (TRAJNER ADMINISTRATORË) TË KUALIFIKUAR SIPAS STANDARTEVE NDËRKOMBËTARE ÆPO STANDARTEVE TË PËRCAKTUARA NGA FEDERATA E JUAJ?

Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja

| | |
|--------------------------|--------------------------|
| 1. TRAJNERË | <input type="checkbox"/> |
| 2. ADMINISTOR TË SPORTIT | <input type="checkbox"/> |

VËREJTJE

Formularit mund t'i bashkangjitet edhe arsyetimi shtesë nëse është e nevojshme për të arsyetuar veprimtarinë, angazhimin rezultatet apo vlerat e Klubit.

| | |
|--------------------------------------|--|
| Emri, Mbiemri i Sekretarit të Klubit | |
| Tel: | |
| E-mail: | |



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO



KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOK
OPŠTINA ISTOK

**PYETËSOR PËR
KATEGORIZIMIN E KLUBEVE SPORTIVE
NË KOMUNËN E ISTOGUT**

Istog, më: ___ / ___ / _____.

Klubi: _____

Përfaqësuesi/ja i/e klubit: _____

Tel: _____

E-mail: _____

| Nr. | KRITERI | TË DHËNAT | |
|-----|--|--------------|--|
| 1. | Kategoria e sportit | | |
| 2. | Tradita e Klubit | | |
| 3. | Numri i sportistëve të regjistruar | | |
| 4. | Niveli i Garave | | |
| 5. | Rezultatet e arritura sportive | | |
| 6. | Angazhimi në përfaqësuese të Kosovës | | |
| 7. | Pjesëmarrja e Klubeve në aktivitete dhe gara | | |
| 8. | Ngritja e kapaciteteve | | |

VËREJTJE

Këtij pyetëSORI duhe t'i bashkangjiten dokumentet me të cilat vërtetohen të dhënat e shënuara në pyetëSOR.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E ISTOGUT / MUNICIPALITY OF ISTOK
DIREKTORATI PËR ADMINISTRIMIN / DIRECTORATE FOR ADMINISTRATION

00 Nr./Br. 059-117 11 Nr. i faq/Br. str. 18

Data/Datum 31 / 12 / 2024
ISTOG • ISTOK



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOK
MUNICIPALITY OF ISTOK

01 Nr:179/2024
Datum: 27.12.2024

[:http://kk.rks-gov.net/istog/](http://kk.rks-gov.net/istog/)

Opštinski Pravilnik Nr. /2022

SKUPŠTINA OPŠTINE

DOPUNSKA IZMENA OPŠTINSKOG PRAVILNIKA br. 2/2022
ZA KATEGORIZACIJU SPORTSKIH KLUBOVA

decembar /2024

Skupština opštine, na osnovu člana 11, člana 12 stav 12.2 tačka (c) i člana 40 stav 40.2 tačka (a) Zakona o lokalnoj samoupravi br. 03/L-040 (Službeni list Republike Kosovo br. 28/2008), član 44. stav 1. pododjeljak 1.3. Zakona br. 08/L-277 za sport (Službeni list Republike Kosovo br. 15/2024) i član 33, stav 33.1 stav 1 Statuta opštine Istok 01 broj 62/2010 usvojen u Skupštini opštine 30.11. 2010. godine, na sastanku održanom 27.12.2024 ovo:

PRAVILNIK ZA KATEGORIZACIJU SPORTSKIH KLUBOVA

Član 1

Svrha

Ova Uredba definiše pravila, kriterijume, procedure i bodovanje za kategorizaciju sportskih klubova opštine Istok koji učestvuju u sportskim takmičenjima koje organizuju sportski savezi registrovani u Ministarstvu kulture, omladine i sporta Republike Kosovo i Opštini. od Istoka.

Član 2

Obim

1. Odredbama ove Uredbe uređuju se:

- 1.1. Način kategorizacije sportskih klubova;
- 1.2. Kriterijumi za kategorizaciju sportskih klubova;
- 1.3. Procedure za kategorizaciju svih sportskih klubova;
- 1.4. Žalbene procedure;
- 1.5. Završne odredbe.

Član 3

Način kategorizacije sportskih klubova

1. Kategorizaciju sportskih klubova izvršila je Komisija za kategorizaciju sportskih klubova Opštine Istok, uzimajući u obzir kriterijume za kategorizaciju sportskih klubova koji su definisani odredbama ove Uredbe.

2. Kategorizacija sportskih klubova opštine Istok se na osnovu ove Uredbe vrši jednom godišnje, a da bi stekli pravo na kategorizaciju, sportski klubovi moraju doneti sledeću dokumentaciju:

- 2.1. Potvrda o registraciji kluba;
 - 2.2. Potvrda br. fiskalni;
 - 2.3. Potvrda bankovnog računa kluba;
 - 2.4. Kopija lične karte/pasoša predstavnika kluba;
 - 2.5. Potvrda da klub nema poreske obaveze od PAK-a;
 - 2.6. Akcioni plan;
 - 2.7. Strateški plan;
 - 2.8. Izveštaj o radu i finansijski izveštaj nezavisnog revizora (za klubove koji ispunjavaju kriterijume za reviziju prema Zakonu o sportu), za prethodnu godinu;
3. Svi dokazi potrebni za ispunjavanje kriterijuma za bodovanje moraju biti izdati od strane relevantnih sportskih saveza.

Član 4

Kriterijumi za kategorizaciju sportskih klubova

1. Kriterijumi za kategorizaciju sportskih klubova su sljedeći:

- 1.1. Sportska kategorija, prema Nacionalnoj sportskoj kategorizaciji - KRITERIJ I;
- 1.2. Tradicija Kluba sportova (godina osnivanja Kluba) – KRITERIJ II;
- 1.3. Broj prijavljenih sportista - KRITERIJ III;
- 1.4. Nivo takmičenja na kojima Klub učestvuje - KRITERIJ IV;
- 1.5. Ostvareni sportski rezultati - KRITERIJ V;
- 1.6. Angažovanje u Predstavništvu Kosova - KRITERIJ VI;
- 1.7. Učešće klubova u aktivnostima i takmičenjima - KRITERIJ VII;
- 1.8. Izgradnja kapaciteta - KRITERIJ IX;

1. Ispunjenost kriterijuma iz člana 4. ovog pravilnika obuhvata sve kategorije (sve starosne grupe za muškarce i žene) sportista, ali se broj bodova za nove kategorije smanjuje, a bodovanje važi prema tabeli i podjela po starosnim grupama kako slijedi:

- 2.1. Mlađi učenici (7, 8, 9 godina) ili U7, U8, U9 i U10
- 2.2. Studenti (10, 11 godina) ili starosna grupa U12
- 2.3. mlađi kadeti (12, 13 godina) ili starosna grupa U14 (ispod 14 godina)
- 2.4. Kadeti (14, 15 godina) ili U16 (međunarodna takmičarska kategorija)

2.5. Juniori (16, 17 godina) ili U18

2.6. Mladi seniori (18, 19, 20 godina) ili U21

2.7. Seniori (stariji od 18 godina)

| starost / kategorija | Koeficienti u odnosu na bodove seniora (100 %) |
|--|--|
| Seniori (18 +) | 1/1 (100 %) |
| Mladi Seniori (18, 19, 20 vjeç) U21 | 3/4 (75 %) |
| Juniori (16, 17 god) U18 | 1/2/ (50 %) |
| Kadeti (14, 15 god) U16 | 1/3 (33.33 %) |
| Mladi sportisti (U7 - U10, ućenici U12 dhe Mlađi kaderti 12, 13 vjgodeç U14) | 1/4 (25 %) |
| | |

1. Sportski rezultat pojedinačnog sportskog kluba priznaje se kao rezultat ekipnog sporta, pod uslovom da taj rezultat prihvati nadležni sportski savez.

2. Sportski klubovi koji imaju registrovane sportiste i sportistkinje u savezima, 30% žena i 70% muškaraca (3 boda), 20% žena i 80% muškaraca (2 boda), te 10% žena i 90% muškaraca (1 bod).

Član 5

Postupak za kategorizaciju sportskih klubova

1. Komisija za kategorizaciju sportskih klubova obrazuje se odlukom načelnika opštine uz poštovanje Zakona br. 05/L-020 za rodnu ravnopravnost sa ovim sastavom:

Komisija se sastoji od 5 članova,

1.1. Predsjednik Komisije, direktor DKRS

1.2. Dokazani član u oblasti sporta

1.3. Tri člana iz institucije

1.4. Rezervni član

2. U toku rada Komisija vodi zapisnik koji na kraju potpisuju članovi Komisije.

3. Komisija ocjenjuje klubove bodovima prema kriterijima utvrđenim ovim Pravilnikom, a odluka o kategorizaciji sportskih klubova mora biti donesena najkasnije do 31. marta.

Član 6

Podnošenje obrasca za prijavu

1. DKRS najkasnije do 1. marta objavljuje na internet stranici opštine Javni poziv za kategorizaciju sportskih klubova. Obrazac definiše relevantne dokaze koje Klub mora donijeti.

2. Ukupna finansijska vrijednost za Kategorizaciju sportskih klubova utvrđuje se obavještenjem DKRS.

3. Sportski klubovi su dužni da popune formular i prilože prateću dokumentaciju koja je tražena u obrascu zajedno sa relevantnim dokazima, koje dostavljaju DKRS-u preko Uslužnog centra za građane broj 100, u zatvorenoj koverti 15. mart.

4. Ukoliko relevantni klubovi kasno dostave obrazac i relevantnu dokumentaciju, ili se utvrdi da priloženi dokazi nisu bili u skladu sa zahtjevima u obrascu, ista prijava neće biti prihvaćena i Klub neće biti kategoriziran.

Član 7

Pregled dokumentacije i rang lista

1. Komisija ispituje prijave oslanjajući se na kriterije definirane ovom Uredbom;
2. Komisija ocjenjuje relevantnu dokumentaciju, priprema prijedloge za rangiranje koje zatim odobrava.
3. Komisija je dužna da najkasnije do 31. marta odobri listu sa kategorizacijom sportskih klubova.

Član 8

Pravo žalbe, rokovi i postupak

1. Klubovi nezadovoljni bodovanjem i plasmanom po grupama mogu podnijeti prigovor Žalbenoj komisiji u roku od 5 dana od dana objavljivanja liste.

2. Žalbena komisija za kategorizaciju sportskih klubova Opštine Istok, nakon razmatranja žalbe, odlučuje većinom glasova i donosi konačnu odluku u roku od 5 dana po podnetoj žalbi.
3. Komisiju za žalbe u vezi kategorizacije sportskih klubova opštine Istok osniva predsjednik opštine.
4. Žalbena komisija ima predsjednika (koji mora biti pravnik) i još 2 člana, koji ni na koji način ne smiju biti politički imenovani članovi. Komisija će imati 2-godišnji mandat.
5. Protiv odluke Komisije za žalbe ne može se podnijeti žalba ustanovi.

Član 9

Odluka o kategorizaciji sportskih klubova

Komisija za kategorizaciju sportskih klubova je dužna sačekati konačnu odluku Komisije za žalbe u vezi kategorizacije sportskih klubova i odlučiti u skladu sa konačnom odlukom Komisije za žalbe za kategorizaciju sportskih klubova i objaviti listu. .

Član 10

Finansijska podrška sportskih klubova po kategorizaciji

1. Finansijska podrška sportskim klubovima zasniva se na Kategorizaciji Sportskog kluba za prošlu godinu kao i odobrenom budžetu za odgovarajuću godinu.
2. Nakon odluke Komisije za kategorizaciju sportskih klubova, DKRS preporučuje pismeni sporazum o finansijskoj podršci sa odgovarajućim sportskim klubovima na osnovu aktivnosti i finansijskog plana predstavljenog od strane sportskih klubova.

Član 11
Aneks Uredbe

1. Komisija za kategorizaciju sportskih klubova Opštine Istok je dužna da sačini obrazac sa relevantnim pitanjima, uključujući sve kriterijume i uslove definisane ovom Uredbom.
2. Tabela za bodovanje i obrazac sa relevantnim pitanjima su sastavni dio ove Uredbe.

Član 12
Izmjene i dopune

Izmjene i dopune ovog Pravilnika vrše se na isti način kao i njegovo odobrenje.

Član 13
Stupanje na snagu

Ova Uredba stupa na snagu nakon ispunjenja uslova utvrđenih u skladu sa članovima 81. i 82. LVL-a, kao i objavljivanja na službenim jezicima na internet stranici opštine.

Predsedavajući Skupštine
g. Enver Rugova





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO



KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOK
OPŠTINA ISTOK

**TABELA POENTUESE PËR
KATEGORIZIMIN E KLUBEVE SPORTIVE**

| Nr. | KRITERET | Pikët |
|------------|--|--------------|
| 1. | Kategorizimi i Sportit në nivel Nacional | |
| 1.1 | Kategoria A | 4.0 |
| 1.2 | Kategoria B | 2.0 |
| 1.3 | Kategoria C | 1.0 |
| 1.4 | Kategoria D | 0.5 |
| 2. | Tradia e Klubit | |
| 2.1 | Klubi me traditë i formuar nga 1990 dhe më përpara | 2.0 |
| 2.2 | Klubi me traditë i formuar nga 1991-2000 | 1.5 |
| 2.3 | Klubi me traditë i formuar nga 2001-2015 | 1.0 |
| 2.4 | Klubi me traditë i formuar nga 2015 e tutje | 0.5 |
| 3. | Numri Sportistëve të regjistruar | |
| 3.1 | 60 sportistë e më shumë | 4.0 |
| 3.2 | Nga 40-59 sportistë | 3.0 |
| 3.3 | Nga 20-39 sportistë | 2.0 |

| | | |
|------------|--|-----|
| 3.4 | Nga 10-19 sportistë | 1.0 |
| 4 | Niveli i garave | |
| 4.1 | Klubi që garon në ligën e I | 6.0 |
| 4.2 | Klubi që garon në ligën e II | 4.0 |
| 4.3 | Klubi që garon në ligën e III | 2.0 |
| 4.4 | Klubi që garon në Ligë Unike | 4.0 |
| 5. | Rezultatet e arritura sportive | |
| 5.1 | Rezultatet e arritura sportive në sportet ekipore | |
| 5.1.1 | Klubi – Super Liga (Liga I) – Vendi I | 20 |
| 5.1.2 | Klubi – Super Liga (Liga I) – Vendi II | 15 |
| 5.1.3 | Klubi – Liga I ose Liga e II – Vendi I | 12 |
| 5.1.4 | Klubi – Liga I ose Liga e II – Vendi II | 8.0 |
| 5.1.5 | Klubi – Liga II ose Liga III – Vendi I | 6.0 |
| 5.1.6 | Klubi – Liga II ose Liga III – Vendi II | 4.0 |
| 5.1.7 | Klubi i cili merr pjesë në gara ndërkombëtare. (për çdo raund të kaluar në këto gara klubi poentohet me +1 pikë) | 4.0 |
| 5.2 | Rezultatet e arritura sportive në garat për Kupën e Kosovës | |
| 5.2.1 | Klubi – Fitues i Kupës së Kosovës | 15 |
| 5.2.1 | Klubi – Finalist i Kupës së Kosovës | 11 |
| 5.2.3 | Klubi – Gjysëm finalist i Kupës së Kosovë (1/2 e finales së Kupës) | 4.0 |
| 5.3 | Rezultatet e arritura sportive në sportet individuale | |
| 5.3.1 | Për çdo medalje në Lojërat Olimpike klubi merr | |
| | - Për medaljen e artë | 100 |
| | - Për medaljen e argjendtë | 70 |
| | - Për medaljen e bronzte | 45 |
| | Kurse për vendet 4 – 8 merr respektivisht 30, 25, 22, 18 dhe 16 pikë | |
| 5.3.2 | Për çdo medalje në Kampionate Botërore klubi merr | |
| | - Për medaljen e artë | 85 |
| | - Për medaljen e argjendtë | 60 |
| | - Për medaljen e bronzte | 35 |
| | Kurse për vendet 4 – 8 merr respektivisht 28, 24, 22, 18 dhe 15 pikë | |
| 5.3.3 | Për çdo medalje në Kupa Botërore klubi merr | |
| | - Për medaljen e artë | 65 |
| | - Për medaljen e argjendtë | 45 |
| | - Për medaljen e bronzte | 30 |
| | Kurse për vendet 4 – 8 merr respektivisht 22, 18, 15, 12 dhe 10 pikë | |
| 5.3.4 | Për çdo medalje në Lojërat dhe Kampionatet Europiane klubi merr | |

| | | |
|-----------|--|-----|
| | - Për medaljen e artë | 55 |
| | - Për medaljen e argjendtë | 40 |
| | - Për medaljen e bronzte | 25 |
| | Kurse për vendet 4 – 8 merr respektivisht 20, 15, 12, 9 dhe 7 pikë | |
| 5.3.5 | Për çdo medalje në Kupat Europiane klubi merr | |
| | - Për medaljen e artë | 45 |
| | - Për medaljen e argjendtë | 30 |
| | - Për medaljen e bronzte | 20 |
| | Kurse për vendet 4 – 8 merr respektivisht 15, 12, 10, 8 dhe 6 pikë | |
| 5.3.6 | Për çdo medalje në Lojërat dhe Kampionatet Mesdhetare klubi merr | |
| | - Për medaljen e artë | 20 |
| | - Për medaljen e argjendtë | 14 |
| | - Për medaljen e bronzte | 8 |
| | Kurse për vendet 4 – 6 merr respektivisht 5, 4 dhe 3 pikë | |
| 5.3.7 | Për çdo medalje në Kampionatet Ballkanike klubi merr | |
| | - Për medaljen e artë | 15 |
| | - Për medaljen e argjendtë | 10 |
| | - Për medaljen e bronzte | 6 |
| | Kurse për vendet 4 – 5 merr respektivisht 4 dhe 3 pikë | |
| 5.3.8 | Për çdo medalje në Kampionatin e Kosovës klubi merr | |
| | - Për medaljen e artë | 4 |
| | - Për medaljen e argjendtë | 3 |
| | - Për medaljen e bronzte | 2 |
| 5.3.9 | Për çdo medalje në Kupën e Kosovës klubi merr | |
| | - Për medaljen e artë | 3 |
| | - Për medaljen e argjendtë | 2 |
| | - Për medaljen e bronzte | 1 |
| 5.3.10 | | |
| | | |
| | | |
| 6. | Angazhimi në përfaqësuese | |
| 6.1 | Për çdo sportist të angazhuar në përfaqësuese | 2.0 |
| 6.2 | Për çdo trajner të angazhuar në përfaqësuese | 2.0 |
| | | |
| 7. | Pjesëmarrja në gara | |
| 7.1 | Klubi që merrë pjesë në 30 e më shumë gara | 4.0 |
| 7.2 | Klubi që merrë pjesë në 20-29 gara | 3.0 |
| 7.3 | Klubi që merrë pjesë në 15-19 gara | 2.0 |
| 8. | Ngritja e kapaciteteve | |
| 8.1 | Për çdo trajner me licencë të njohur ndërkombëtare | 3.0 |

| | | |
|-----|---|-----|
| 8.2 | Për çdo trajner me licencë të njohur nacionale | 2.0 |
| 8.3 | Për çdo administrator të sportit me licencë të njohur | 1.0 |
| | | |
| | | |
| | | |



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO



KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOK
OPŠTINA ISTOK

FORMULARI PËR APLIKIM PËR KATEGORIZIMIN E KLUBEVE
SPORTIVE

Istog, më: ___ / ___ / _____.

Klubi: _____

Përfaqësuesi/ja i/e klubit: _____

Tel: _____

E-mail: _____

Kriteri 1: Sipas rangut të sportit në nivel nacional.

| | |
|--|--------------------------|
| NË CILËN KATEGORI, RANG BËNË PJESE SPORTI ME TË CILIN MERRET KLUBI JUAJ, SIPAS KATEGORIZIMIT NACIONAL? | |
| Duhet të sillni deshmi për të vërtetuar të dhënat | |
| ➤ Në rangun I | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Në rangun II | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Në rangun III | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Në rangun IV | <input type="checkbox"/> |

Kriteri 2: Tradita e klubit

| | |
|---|--------------------------|
| CILA ËSHTË TRADITA E KLUBIT TUAJ, APO KUR ËSHTË FORMUAR KLUBI JUAJ? | |
| Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat. | |
| ➤ Klubi me traditë i formuar nga viti 1990 dhe më përpara | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi me traditë i formuar nga viti 1991-2000 | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi me traditë i formuar nga viti 2001-2015 | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi me traditë i formuar nga viti -2015 e tutje | <input type="checkbox"/> |

Kriteri 3: Masiviteti sipas numrit të sportistëve të regjistruar në federatë

| | |
|--|--------------------------|
| SA ËSHTË NUMRI I SPORTISTEVE TË KLUBIT TUAJ TË REGJISTRUAR NË FEDERATËN TUAJ PËRKATËSE? | |
| Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat, të bashkangjitet lista e sportisteve të | |
| ➤ Klubi ka të regjistruar 60 sportistë e më shumë | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi ka të regjistruar 40-59 sportistë | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi ka të regjistruar 20-39 sportistë | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi ka të regjistruar 10-19 sportistë | <input type="checkbox"/> |

- | | |
|--|--------------------------|
| ➤ Nëse raporti i numrit të përgjithshëm të femrave sportiste me numrin e meshkujve sportistë është së paku 30:70 | <input type="checkbox"/> |
|--|--------------------------|

Kriteri 4: Niveli i garave, rangu ku klubi zhvillon gara

NË CILIN NIVEL, RANG APO KATEGORI ZHVILLON GARA KLUBI I JUAJ?

Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja

| | |
|--|--------------------------|
| ➤ Klubi juaj bënë gara në rangun e parë të garave në federatën tuaj | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi juaj bënë gara në rangun e dytë të garave në federatën tuaj | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi juaj bënë gara në rangun e tretë të garave në federatën tuaj | <input type="checkbox"/> |

Kriteri 5: Rezultatet sportive

Kriteri 5.1: Rezultatet e arritura në garat ndërkombëtare

A KENI NDONJË SPORTISTË NË KLUBIN TUAJ QË KA FITUAR MEDALJE NË LOJRAT OLIMPIKE (LO), NË LOJRAT PARA – OLIMPIKE, NË KAMPIONATIN BOTËROR (KB) LOJRAT DHE KAMPIONATET EVROPIANE, LOJRAT MESDHETARE APO KAMPIONATET BALLKANIKE, APO QË ËSHTË RADHITUR NGA VENDI 4-TË DERI NË VENDIN E 8-TË.

Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja

| | |
|--|--|
| ➤ Shëno kampionatin, Garën në të cilën është arritur rezultati (vendi, data) | |
| ➤ Emri dhe Mbiemri i Sportistit | |
| ➤ Rezultati i arritur | |
| ➤ Kategoria/ disiplina | |

Kriteri 5.2: Rezultatet e arritura në garat vendore

A KENI NDONJË SPORTIST NË KLUBIN TUAJ QË KA FITUAR MEDALJE TË ARTË, TË ARGJENDTË APO TË BRONZTË NË KAMPIONATIN E KOSOVËS, APO NË NË KUPËN E

REPUBLIKËS SË KOSOVËS?

Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja

| | |
|---|--|
| ➤ Shëno Kampionatin, garën ku është arritur rezultati (vendi, data) | |
| ➤ Emri dhe Mbiemri i sportistit | |
| ➤ Rezultati i arritur | |
| ➤ Kategoria/ disiplina | |

Kriteri 6: Përfaqësimi, angazhi mi i sportistëve dhe trajnerëve në përfaqësuese

A KENI NDONJË SPORTIST APO TRAJNER NË KLUBIN TUAJ I CILI ËSHTË ANGAZHUAR NË PËRFAQËSUESEN E KOSOVËS?

Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja.

| | |
|--|--------------------------|
| ➤ Klubi juaj në përfaqësuesen e Kosovës a ka të angazhuar sportist | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi juaj në përfaqësuesen e Kosovës a ka të angazhuar trajner | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Emri dhe Mbiemri i sportistit apo trajnerit | |
| ➤ Kategoria | |

Kriteri 7: Pjesëmarrja në aktivitete dhe gara

A KA MARRË PJESË KLUBI JUAJ NË AKTIVITETE APO GARA TË NDRYSHME SPORTIVE? SHËNONI NË SA PREJ TYRE DHE CILAT JANË ATO?

Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja.

| | |
|---|--------------------------|
| ➤ Klubi juaj ka marrë pjesë në 30 e më shumë aktivitete gjatë vitit | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi juaj ka marrë pjesë në 20-29 aktivitete gjatë vitit | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi juaj ka marrë pjesë në 15 - 19 aktivitete gjatë vitit | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Përshkrimi i aktivitetit të organizuar | |
| ➤ Data | |
| ➤ Vendi | |

Kriteri 9: Ngritja e kapaciteteve

A KENI NDONJË ZYRTARË TË SPORTIT (TRAJNER ADMINISTRATORË) TË KUALIFIKUAR SIPAS STANDARTEVE NDËRKOMBËTARE APO STANDARTEVE TË PËRCAKTUARA NGA FEDERATA E JUAJ?

Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja

| | |
|--------------------------|--------------------------|
| 1. TRAJNERË | <input type="checkbox"/> |
| 2. ADMINISTOR TË SPORTIT | <input type="checkbox"/> |

VËREJTJE

Formularit mund t'i bashkangjitet edhe arsyetimi shtesë nëse është e nevojshme për të arsyetuar veprimtarinë, angazhimin rezultatet apo vlerat e Klubit.

| | |
|--------------------------------------|--|
| Emri, Mbiemri i Sekretarit të Klubit | |
|--------------------------------------|--|

| | |
|---------|--|
| Tel: | |
| E-mail: | |



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO



KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOK
OPŠTINA ISTOK

**PYETËSOR PËR
KATEGORIZIMIN E KLUBEVE SPORTIVE
NË KOMUNËN E ISTOGUT**

Istog, më: ___ / ___ / _____.

Klubi: _____

Përfaqësuesi/ja i/e klubit: _____

Tel: _____

E-mail: _____

| Nr. | KRITERI | TË DHËNAT | |
|-----|--|--------------|--|
| 1. | Kategoria e sportit | | |
| 2. | Tradita e Klubit | | |
| 3. | Numri i sportistëve të regjistruar | | |
| 4. | Niveli i Garave | | |
| 5. | Rezultatet e arritura sportive | | |
| 6. | Angazhimi në përfaqësuese të Kosovës | | |
| 7. | Pjesëmarrja e Klubeve në aktivitete dhe gara | | |
| 8. | Ngritja e kapaciteteve | | |

VËREJTJE

Këtij pyetësori duhe t'i bashkangjiten dokumentet me të cilat vërtetohen të dhënat e shënuara në pyetësor.